

1. Titulli i projektit:	Përforcimi i Rrjetit të Tensionit të Ulët 2014 – Dislokimi i njehsorëve Distrikti i Ferizajt
2. Përshkrimi i projektit:	<p>Fushëveprimi i këtij projekti përfshin furnizimin me material, instalimin, testimin dhe komisionimin kryesisht të rrjetit të tensionit të ulët 0.4 kV të shpërndarjes në regjionet e Distriktit të Ferizajt. Projekti përfshin ndërtimin dhe komisionimin e:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Linjave ajrore 10(20) kV; • Rrjetin e tensionit të ulët 0,4 kV; • Vendosjen e ormanëve jashtë oborreve të konsumatorëve dhe zhvendosjen e njehsorëve (pikës matëse) <p>Arsyetimi: Rrjeti i vjetërsuar i distribuimit të energjisë i trashëguar nga KEDS nuk garanton cilësi dhe siguri të furnizimit me energji. Si rrjedhojë e rrjetit të vjetruar dhe rritjes së numrit të konsumatorëve të amvisërisë (rezidencial) dhe komercial dhe rrjedhimisht rritjes së konsumit të energjisë, kapacitetet aktuale nuk i plotësojnë kriteret teknike dhe si pasojë cilësia e furnizimit deri tek konsumatori i fundit nuk është në nivel të kënaqshëm dhe në kufijtë e kërkuar teknik.</p> <p>Për më tepër, rreth 1260 konsumatorë do të ndikohen drejtpërdrejt nga 10 projektet që janë duke u implementuar bashkë me këtë projekt. Konsumatorët që do të përfitojnë nga këto projekte</p>

	<p>janë furnizuar përmes linjave të gjata dhe të vjetruara 0,4 kV dhe aktualisht janë duke u përballur me rënie të tensionit sidomos gjatë orëve të pikut (shfrytëzimit maksimal) të energjisë elektrike.</p> <p>Objektivat e projektit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kualitetit dhe rritja e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike; • Përkrahja e rritjes së ngarkesës; • Eliminimi i fyteve të ngushta; • Reduktimi i humbjeve teknike; • Reduktimi i rënieve të tensionit; • Reduktimi i orëve të humbura për konsumator (SAIDI, SAIFI). etj.
3. Data e fillimit:	16 prill 2014
4. Data e përfundimit:	31 dhjetor 2014
5. Kostoja e projektit	0,9 milion €
6. Sponsor i projektit:	KEDS, Divizioni i Rrjetit
7. Njësia Sponsor:	Departamenti për Kontrollin e Investimeve

Nr.	Përshkrimi i projektit	Data e fillimit	Data e përfundimit
1	TS 10/0,4kV Babush Blinda Lipjan	28.04.2014	31.12.2014
2	TS 10/0,4kV Babush e Vjetra Lipjan	30.04.2014	31.12.2014
3	TS 10/0,4kV Tern Lipjan	06.05.2014	31.12.2014
4	TS 10/0,4kV Shalë Emërllahët Magure	28.04.2014	31.12.2014
5	TS 10/0,4kV Cërnillë Lipjan	29.05.2014	28.10.2014
6	TS 10/0,4kV Rubovc Lipjan	29.05.2014	28.10.2014
7	TS 10/0,4kV Pleshinë Ferizaj	29.05.2014	28.10.2014
8	TS 10/0,4kV Muzeqinë e vjetra Shtime	29.05.2014	31.12.2014
9	TS 10/0,4kV Qiraxhi Ferizaj	27.06.2014	31.12.2014
10	TS 10/0,4kV Nerodime Ferizaj	23.08.2014	31.12.2014